

Statistikat e transportit

Qershor 2017

Tiranë, më 27 Korrik 2017: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Qershor 2017 është 326 mijë ton. Krahasuar me Qershor 2016, ky tregues është rritur me 2,8 %.

Në gjashtëmuajorin e parë 2017, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.947 mijë ton, duke u rritur me 6,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Porti i Durrësit zë 92,0 %, të gjithë mallrave të ngarkuara/shkarkuara në të gjitha portet.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 2,4 mln ton - kilometër, duke u rritur 4 herë më shumë, krahasuar me Qershor 2016.

Në gjashtëmuajorin e parë 2017, ky volum është 12 mln ton- kilometër, duke u rritur me 175,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, me hekurudhë dhe me ajër

ton

| Periudha | Me det | Me hekurudhë | Me ajër* |
|--------------------------------|-----------|--------------|----------|
| Qershor - 2016 | 317.260 | 3.040 | 182 |
| Qershor - 2017 | 325.630 | 11.905 | 194 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 2,6 | 291,6 | 6,8 |
| Janar - Qershor 2016 | 1.821.303 | 37.110 | 1.075 |
| Janar - Qershor 2017 | 1.947.460 | 81.550 | 1.101 |
| Ndryshimi vjetor progresiv (%) | 6,9 | 119,8 | 2,5 |

*Përfshin mallrat dhe postën

Në muajin Qershor 2017, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 153 ton, duke u rritur 5,5 %, krahasuar me Qershor 2016.

Në gjashtëmuajorin e parë të 2017, me ajër janë transportuar 878 ton mallra, duke u rritur 5,7 %, krahasuar me gjashtëmuajorin e parë të 2016.

Për publikim 27/07/2017

Numri i fluturimeve të kryera, në Qershor 2017, është 2.046, duke shënuar një rritje me 20,4 %, ndaj Qershor 2016.

Në gjashtëmuajorin e parë 2017, janë kryer 10.742 fluturime, duke u rritur me 9,0 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

| Periudha | Numri i shoqërive ajrore | Numri i fluturimeve | Numri mbikalimeve |
|--------------------------------|--------------------------|---------------------|-------------------|
| Qershor - 2016 | 15 | 1.700 | 18.048 |
| Qershor - 2017 | 18 | 2.046 | 17.482 |
| Ndryshimi vjetor (%) | 20,0 | 20,4 | -3,1 |
| Janar - Qershor 2016 | 15 | 9.852 | 69.419 |
| Janar - Qershor 2017 | 18 | 10.742 | 68.698 |
| Ndryshimi vjetor progresiv (%) | 20,0 | 9,0 | -1,0 |

Në muajin Qershor, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 229.584, duke u rritur 26,4 %, krahasuar me Qershor 2016.

Në gjashtëmuajorin e parë 2017, transporti ajror i pasagjerëve zë 63,9 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në gjashtëmuajorin e parë 2017 është 1.120.326, duke u rritur me 22,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

| Periudha | Transporti i pasagjerëve | | |
|--------------------------------|--------------------------|---------|-----------|
| | Me hekurudhë | Me det | Me ajër |
| Qershor - 2016 | 9.330 | 92.129 | 181.574 |
| Qershor - 2017 | 8.982 | 120.984 | 229.584 |
| Ndryshimi vjetor (%) | -3,7 | 31,3 | 26,4 |
| Janar - Qershor 2016 | 54.960 | 394.748 | 915.542 |
| Janar - Qershor 2017 | 24.439 | 466.534 | 1.120.326 |
| Ndryshimi vjetor progresiv (%) | -55,5 | 18,2 | 22,4 |

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Qershor 2017 është 120.984 persona, krahasuar me Qershor 2016, ky tregues është rritur 31,3 %.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2017, kanë udhëtuar me linjë detare 466.534 pasagjerë, duke u rritur me 18,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Eksporti/Importi i mallrave sipas mënyrës së transportit


Në Qershor 2017, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 79 mld lekë dhe 53,8 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Qershor 2017, mallrat e eksportuara me det zënë 62,1 %, me rrugë 36,7 % dhe me ajër 0,7 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në Qershor 2017, janë rritur me 17,8 % dhe me det janë ulur 2,7 %, krahasuar me Qershor 2016.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2017



Në gjashtëmuorin e parë 2017, mallrat e eksportuara me det zënë 63,8 %, me rrugë 34,8 % dhe me ajër 0,4 %.


Mallrat e eksportuara me rrugë, në gjashtëmuorin e parë 2017, u rritën 25,3 % dhe me det u rritën 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Importet e mallrave

Në Qershor 2017, mallrat e importuara me det zënë 50,5 %, me rrugë 44,1 % dhe me ajër 2,3 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në Qershor 2017, janë rritur 4 herë dhe me det janë rritur me 1,0 %, krahasuar me Qershor 2016.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2017




Në gjashtëmuajorin e parë 2017, mallrat e importuara me det zënë 50,4 %, me rrugë 43,8 % dhe me ajër 2,9 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në gjashtëmuajorin e parë 2017, janë rritur 78,3 % dhe me det janë ulur me 0,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Mallrat kryesore të eksportuara sipas mënyrës së transportit

Pesë grup-mallra, sipas Nomenklaturës së Transportit (NST 2007), kanë kontribuar me 77,9 %, në vlerën e mallrave të eksportuara në muajin Qershor 2017.


Fig. 3 Pesë grup-mallra kryesore të eksportuara sipas mënyrës së transportit



Mallrat kryesore të importuara sipas mënyrës së transportit

Pesë grup-mallra, sipas Nomenklaturës së Transportit (NST 2007), kanë kontribuar me 72,3 % të vlerës së mallrave importuar gjithsej në muajin Qershor 2017.

Fig. 4 Pesë grup-mallra kryesore të importuara sipas mënyrës së transportit



Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë